



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AGJENCIA E PROKURIMIT PUBLIK
DREJTORIA JURIDIKE, E VERIFIKIMIT DHE INTEGRIMIT

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më _____. _____. 2020

Të dhëna mbi vendimin e APP Nr. 11, datë 20.02.2020

Agjencia e Prokurimit Publik (në vijim "APP") në mbështetje të nenit 13/3/ç të Ligjit Nr. 9643, datë 20.11.2006 "Për prokurimin publik" të ndryshuar, APP me Vendimin Nr. 82, datë 23.12.2019, ka vendosur të përjashtojë për një periudhë për 2 (dy) vjeçare operatorin ekonomik "ABCom" Shpk, me NIPT K11308001B, nga pjesëmarrja në procedurat e prokurimit publik, për mospërmbushje të detyrimeve kontraktuale në kontratat publike.

I. Arsytet e heqjes së emrit të operatorit ekonomik nga lista e operatorëve ekonomikë të përjashtuar nga pjesëmarrja në procedurat e prokurimit publik.

Kundër vendimit Nr. 82, datë 23.12.2019, të APP, operatorin ekonomik "ABCom" Shpk, me NIPT K11308001B, i është drejtuar Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, duke kërkuar shfuqizimin e këtij vendimi.

Me vendimin Nr. 486 (80-2020-487), datë 14.02.2020, Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë, ka vendosur pranimin e kërkesë padisë, si dhe dhënien e vendimit të saj me ekzekutim të përkohshëm.

Në nenin 510/a të Kodit të Procedurës Civile parashikohet se: "Janë tituj ekzekutivë: a) vendimet civile të formës së prerë të gjykatës, që përmban një detyrim, vendimet e dhëna prej saj për sigurimin e padisë, si dhe për ekzekutimin e përkohshëm".

Në këto kushte, APP, në mbështetje edhe të nenit 180, pika 1, gërma "b" të Ligjit Nr. 44/2015 "Kodi i procedurave administrative në Republikën e Shqipërisë", ka proceduar me heqjen e këtij operatori ekonomik nga lista e operatorëve ekonomikë të përjashtuar nga pjesëmarrja në procedurat e prokurimit publik, që publikohet në Buletinin e Njoftimeve Publike, si dhe në faqen zyrtare të APP, deri në marrjen e një vendimi përfundimtar nga Gjykata Administrative e Apelit.